

VENDIM ASAMBLEJE ORTAKU I VETEM  
PER

"PERFUNDIM PROCEDURE BASHKIM ME PERTHITHJE SHOQERIE"

Mbështetur në Neni 215 e ne vijim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare", I Ndryshuar; Statutit te Shoqerise "Klar" shpk;

Në Tiranë, sot më datë 17/01/2015, në selinë e shoqërisë "KLAR" shpk, u mbledh Asambleja e Ortakut te vetem te kesaj shoqërie: SHKELQIM BESHIRI, i biri i Limanit, i dtl 22.08.1966, lindur dhe banues ne Tirane, i pajisur me pashaporte sherbimi nr SE6102016, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

**KONSTATOI:**

Se kjo shoqeri ka kapital themeltar vleren prej 100.000,Lekesh dhe me objekt veprimtarie: 1-Real Estate. 2-Tregti te kafes, imp - eks, te artikujve ushqimore industriale etj. 3-Tregetim me shumice dhe pakice, si dhe ne aktivitetin e import-eksportit te produkteve te ndryshme industriale dhe ushqimore. 4- Prodhim, perpunim, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te drurit dhe produkteve te tyre. 5-Te realizoje ndertime.

Pas diskutimeve dhe konsultimeve me eksperte kontabel, dhe nevojës për t'u zhvilluar ne tregun ekonomike-financiare, Asambleja e Ortakut te vetem te "Klar" shpk, duke qene edhe ortaku i vetem i "Ladjus" shpk ka shqyrtuar situaten ekonomike- financiare dhe ka konkluduar proceduren e bashkimit me perthithje te shoqerise "Ladjus" shpk;

**VENDOSI:**

1. Shoqeria "Klar" shpk se bashku me shoqerine "Ladjus" shpk kane konkluduar proceduren e bashkimit me perthithje duke kryer te gjitha procedurat e domosdoshme ligjore dhe financiare qe rrjedhin nga ky bashkim. "Ladjus" shpk do te jete shoqeria e perthithur, ndersa shoqeria "Klar" shpk do te jete shoqeria perthithese.
2. Per percjelljen e ketij vendimi ne institucionet kompetente, si dhe pergatitjen e te gjithë dokumentacionit lidhur me kete procedure, ngarkohet Administratori i kesaj shoqerie.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

SHOQERIA "KLAR" SHPK  
ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM:  
ORTAK I VETEM  
SHKELQIM BESHIRI

*Shkelqim*  


*Beshiri*